

FJALA E DEPUTETES ENSLEMVERA ZAKE

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Është përgjegjësi publike të flasësh për buxhetin, sepse ky është procesi më i rëndësishëm i kalendarit parlamentar. Ky është buxheti më i madh në historinë e shtetit shqiptar, që financon programin e qeverisë, edhe pse jemi duke jetuar në epokën e rrezikut të madh, ku inflacioni i luftës së Putinit po prek çdo vend në Europë.

Objektivi kryesor i projektbuxhetit të vitit 2023 është t'u qëndrojë sa më pranë qytetarëve, atyre që kanë më shumë nevojë, pensionistëve dhe familjeve me ndihme ekonomike, nënave kryefamiljare me shumë fëmijë dhe të gjithë atyre me aftësi të veçanta. Me të drejtë ata do të pyesin: "Çfarë do të përfitojmë nga ky buxhet?"

Ne vijojmë ta mbajmë të pandryshuar çmimin e energjisë elektrike për familjet dhe biznesin e vogël, duke alokuar një mbështetje buxhetore prej 12 miliardë lekësh në sektorin energjetik gjatë vitit 2023, sepse e kuptojmë që energjia elektrike, sidomos në periudhën e dimrit, është e domosdoshme. Nga viti 2021 buxheti e ka mbështetur mbajtjen e çmimit të energjisë të pandryshuar me 50 miliardë lekë.

Do t'i mbështesim familjet me të ardhura më të ulëta, duke rritur pragun e patatueshëm nga 40 mijë lekë në 50 mijë lekë. Nga kjo masë do të përfitojnë mbi 70 mijë të punësuar. Në buxhetin e shtetit parashikohet të mungojnë rreth 1 deri 1,2 miliardë lekë, por këto të ardhura do të mbeten tashmë në xhepat e qytetarëve, duke rritur konsumin.

Punëmarrësit, nga ndryshimi i nivelit të pagës, do të përfitojnë rreth 1 200 lekë në muaj ose rreth 14 300 lekë në vit.

Vijojmë t'i mbështesim familjet me të ardhura më të ulëta duke rritur nivelin e pagës minimale gjatë vitit 2023 nga 34 000 lekë në 36 000 lekë, nga e cila do të përfitojnë 100 mijë të punësuar me rreth 2,1 miliardë lekë në vit më shumë të ardhura të disponueshme në familjet e tyre.

Mbështesim familjet në nevojë dhe individët me aftësi të kufizuara përmes zbatimit të paketës së re të rezistencës.

Në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike, përfitojnë mesatarisht rreth 220 mijë individë në vit me një kosto prej 25,5 miliardë lekësh për vitin 2023. Kjo masë reflektohet në rritjen me 10% të ndihmës ekonomike. Kjo është rritja e dytë që nga fillimi i këtij mandati. Do të dyfishohet ndihma për nënat me 2 apo me shumë fëmijë, si dhe për të moshuarit mbi 65 vjeç, të cilët nuk marrin pension social apo pension pleqërie.

Për vitin 2023, brenda politikave sociale, risi është politika për mbështetjen e grave të papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri në 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në 5 vjeç, e cila ka një kosto rreth 600 milionë lekë.

Në projektbuxhetin e vitit 2023 parashikohet një garanci sovrane për mbështetjen e 1000 familjeve të reja për blerjen e banesës së tyre të parë. Kjo vlen për punonjësit në profesionin e infermierit dhe për punonjësit në fushën e sigurisë. Kjo masë parashikohet të ketë një efekt në buxhet në vlerën 1,5 miliardë lekë.

Gjithashtu, do të mbështesim pensionistët, ku, përveç indeksimit të pensioneve sipas inflacionit, u garantohet dhënia e bonusit të fundvitit me një kosto totale prej 3,5 miliardë lekësh, pas rritjes me 9,5% këtë vit, pra me një kosto shtesë 8,3 miliardë lekë për vitin 2023.

Për njohuri: në vitin 2013 kostoja e pensioneve ishte rreth 76,9 miliardë lekë, ndërsa në vitin 2023 kostoja është rreth 141,4 miliardë lekë, pra ka një rritje me rreth 84%.

Gjithashtu, do të rriten edhe pagat në arsim, shëndetësi dhe për zjarrfikësit.

Arsimi do të vijojë të financohet përtej nivelit 3% të PBB-së gjatë periudhës 2023-2025. Ne do të vijojmë të mbështesim rritjen e pagave të punonjësve arsimorë, do të ofrojmë më shumë mbështetje buxhetore ndaj arsimit universitar për vazhdimin e procesit të ndërkombëtarizimit të universiteteve.

Shëndetësia do të vijojë të financohet si sektor prioritar, duke qëndruar në nivelin prej 3% të GDP-së gjatë këtyre viteve. Në fokus do të jetë rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore parësore dhe dytësore, si dhe motivimi në vijimësi i personelit shëndetësor me rritje pagash.

Gjithashtu, në fokus të qeverisë mbetet edhe bujqësia, e cila do të përfitojë rreth 14,2 miliardë lekë në vitin 2023. Ky është buxheti më i madh për bujqësinë që i dedikohet rezistencës, rritjes së vazhdueshme dhe rritjes së eksportit. Parashikohet mbështetje për skemën kombëtare të fermerëve me një fond total prej 1,97 miliardë lekësh, me synim rritjen e numrit të përfituesve në 5000 në vitin 2023.

Mbështetje tjetër për fermerët do të jetë edhe një fond prej 3,9 miliardë lekësh përmes financimeve nga projekti IPARD III; për skemën e subvencionimit të naftës do të jetë një fond prej 1,62 miliardë lekësh, ku parashikohet të rritet numri i përfituesve. Buxheti për bujqësinë është 7 herë më i madh se ai i vitit 2013.

Në këtë buxhet një vëmendje e shtuar i kushtohet infrastrukturës digjitale, që përmirëson rrënjësisht shërbimet kundrejt qytetarëve, duke shmangur burokracitë dhe duke rritur efikasitetin në shërbimet publike.

Gjithashtu, një vëmendje do t'i kushtohet edhe sigurisë kibernetike. Ky sektor do të përfitojë rreth 11,3 miliardë lekë në vitin 2023 ose rreth 3 miliardë lekë më shumë se buxheti i rishikuar i vitit 2022.

Spektori i mbrojtjes vijon të finanohet me prioritet, duke arritur rreth 1,85% të PBB-së për vitin 2023, me synim që shpenzimet në këtë sektor në vitin 2024 të arrijnë 2%, si kusht i domosdoshëm i vendosur nga NATO-ja.

Qeveria ka dhënë mbështetje edhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet reformave të ndërmarra, që pasqyrohet në rritjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë, e cila, në krahasim me vitin 2022, është rritur në vlerën 3 miliardë lekë. Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar në masën 9% tregon rëndësinë që i është kushtuar procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore.

Pagat e administratës vendore për vitin 2023 do të jenë të rritura. Rritje të ndjeshme të pagave do të ketë për arsimin parashkollor, arsimin parauniversitar, për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri, për administrimin e pyjeve dhe për ujitjen dhe kullimin me një fond prej 340 milionë lekësh.

Do të vijojë mbështetja për reformën e financimit të arsimit parashkollor. Kostoja e kësaj reforme është 327 milionë lekë, e cila mbulon transfertën e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2023 dhe garanton vazhdimin e shërbimit me mbi 400 edukatorë shtesë, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit në kopshte.

Investimet publike mbeten shtylla e dytë më e rëndësishme e këtij projektbuxheti. Për vitin 2023 parashikohet të jenë 5,6% të GDP-së ose 122,2 miliardë lekë, që është një nivel mjaftueshëm i lartë për përmirësimin e gjithanshëm të infrastrukturës së vendit, ku përparësi do të ketë financimi i projekteve në vazhdim.

Lajmi i mirë për qytetarët e zonës që përfaqësoj është vijimi i projekteve infrastrukturore të tilla, si: rikonstruksioni i godinës qendrore të spitalit të Korçës së bashku me pajisjet mjekësore dhe mobilimin spitalor. Këtu gjej rastin të falënderoj ministren e Shëndetësisë!

Do të vijojë zgjerimi i rrugës Elbasan–Qafë-Thanë (faza II); shtesa dhe rikonstruksioni për shkollën e mesme të përgjithshme "Themistokli Gërmenji"; ndërtimi i rrugës Korçë – Ersekë (loti i 2, faza e dytë); investimet e ujësjellësve në zonat rurale, në njësitë administrative Mollaj, Bulgarec, Voskopojë, Voskop, Drenovë, si dhe ndërtimi i ujësjellësve në fshatrat Floq, Dersnik, Vinçan, Porodinë, Gjomath; rehabilitimi i kanalit ujitës, krahu i djathtë i rezervuarit në Gjanç; mbrojtja nga lumi Dunavec në zonën Ravonik – Korçë; sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Boboshticë-kthesa e Dardhës; furnizimi me ujë për Bashkinë e Pustecit; rikonstruksioni i aksit rrugor Maliq– Lozhan i Ri – Strelce; ndërtimi i ujësjellësit Maçurisht-Plasë në Maliq e të tjera.

Projektbuxheti për vitin 2023 shoqërohet me projektligjet e paketës fiskale, fokusi i të cilave është konsolidimi i financave publike, rritja e të ardhurave të buxhetit dhe ulja graduale e deficitit buxhetor dhe e borxhit publik.

Treguesit kryesorë të buxhetit janë shpenzimet publike, që parashikohen të kapin vlerën 687,2 miliardë lekë, ose 31,6% të produktit të brendshëm bruto. Të ardhurat totale në buxhetin e vitit 2023 pritet të jenë 29% e GDP-së, duke kapur vlerën 631,7 miliardë lekë. Pra, në krahasim me vitin 2013 të ardhurat janë rritur me 93%.

Finalizimi dhe zbatimi në një kohë sa më të shpejtë i strategjisë afatmesme të të ardhurave publike, bazuar edhe te rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës së Shqipërisë, ka si synim thjeshtimin e sistemit tatimor, rritjen e qëndrueshmërisë së tij në kohë, shmangien e përjashtimeve tatimore joefektive, rritjen e formalizimit, i cili do të mundësojë grumbullimin e të ardhurave dhe përmirësimin e konkurrencës, si rrjedhojë edhe rritjen e investimeve publike.

Ky projektbuxhet është kujdesur që të ketë prioritet sektorët që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Ndaj, kolegë deputetë, ju ftoj që ta votojmë. Faleminderit!